PSH.nr.743/20

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, në përbërje të: Z. Goran Milenkovic - Kryetar, Z. Nuhi Paçarizi - Referues, Z. Blerim Dina - Anëtarë, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik N.P.N. "Renelual Tahiri" - Prizren, kundër njoftimit për kontratë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Intervenimi në infrastrukturën për rastet e fatkeqësive natyrore dhe eliminimi i deponive ilegale në Komunën e Prizrenit" me nr. të prokurimit: 622-20-4624-2-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Komuna Prizren më datë: 12.11.2020, mori këtë:

V E N D I M

I. **APROVOHET**, si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik N.P.N. "Renelual Tahiri" - Prizren, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Intervenimi në infrastrukturën për rastet e fatkeqësive natyrore dhe eliminimi i deponive ilegale në Komunën e Prizrenit" me nr. të prokurimit: 622-20-4624-2-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Komuna Prizren.

II. **OBLIGOHET**, autoriteti kontraktues – Komuna Prizren, t'i bëjë ndryshimet e nevojshme në dosje të tenderit dhe ti merr parasysh rekomandimet e dhëna në raportin e ekspertizës, lidhur me aktivitetin të prokurimit "Intervenimi në infrastrukturën për rastet e fatkeqësive natyrore dhe eliminimi i deponive ilegale në Komunën e Prizrenit" me nr. të prokurimit: 622-20-4624-2-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Komuna Prizren.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues N.P.N. "Renelual Tahiri" – Prizren, aprovohet si e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Operatori ekonomik ankues N.P.N. "Renelual Tahiri" - Prizren, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me datë 01.10.2020 me nr. 743/20, kundër njoftimit për kontratë lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Intervenimi në infrastrukturën për rastet e fatkeqësive natyrore dhe eliminimi i deponive ilegale në Komunën e Prizrenit" me nr. të prokurimit: 622-20-4624-2-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Komuna Prizren, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenet: 1, 7, 27 dhe 69 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, si dhe neni 18.9 dhe 26.4 të RrUOPP-së.

Organi Shqyrtues i Prokurimit konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 14.10.2020, ka autorizuar ekspertin shqyrtues të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore. Eksperti shqyrtues i prokurimit në raportin e datës: 21.10.2020, lidhur me pretendimet ankimore të OE-ankues sqaron si në vijim:

Pretendimet ankimore kanë të bëjnë kundër njoftimit për kontratë, përkatësisht kundër kërkesës së aplikuar në dosje të tenderit të pikës 9.1 & 9.2, kërkesat e kapacitetit teknik dhe profesional që ndërlidhet me projektet e realizuara, ku përveç tjerash për operatorët ekonomik për t'u kualifikuar si të përgjegjshëm është kërkuar të prezantojnë, projekte të natyrës së kontratës.

Pas administrimit dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës kundrejt pretendimeve ankimore, përkatësisht po t'i referohemi paramasës dhe parallogarisë së këtij aktivitetit të prokurimit, rezulton që natyra e aktivitetit të prokurimit ka të bëjë me kontratë "kombinim", ku përfshihen shërbime, punë dhe furnizime. Sipas nenit 15.3, të RrUOPP-së, cilido element i kontratës i cili ka shpenzimet më të larta duhet të klasifikohet nën atë lloj të kontratës. Megjithatë AK/ Komuna Prizren, me kërkesën e kualifikimit të aplikuar kundrejt operatorëve dhe të kontestuar nga parashtruesi i ankesës "...projekte të natyrës së kontratës...", mund të kufizoj konkurrencën apo edhe të favorizoj operator ekonomik të caktuar, prandaj propozimi ynë është që të mundësohet operatorëve të ofertojnë me " Projekte (të realizuara) të ngjashme me aktivitetin e prokurimit",

me qëllim që të zgjerohet konkurrenca.
Mendimi i ekspertit shqyrtues: Duke u bazuar në sqarimet e cekura në raport, Eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE - të aprovohet si e bazuar dhe AK - Komuna Prizren, t'i bëjë korrigjimet e mundshme në dosje të tenderit dhe t'i njoftoj OE-të e interesuar konform dispozitave të nenit 53.7 të LPP-së.

Autoriteti Kontraktues me datë 21.10.2020, me anë të parashtresës ka njoftuar OSHP-në se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Operatori Ekonomik nuk është deklaruar se a pajtohet apo nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 12.11.2020, pa praninë e palëve konform nenit 24.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues të prokurimit dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues N.P.N. "Renelual Tahiri" – Prizren, se AK përmes kërkesës së aplikuar në dosje të tenderit të pikës 9.1 & 9.2, kërkesat e kapacitetit teknik dhe profesional që ndërlidhet me projektet e realizuara, ku përveç tjerash për operatorët ekonomik për t'u kualifikuar si të përgjegjshëm është kërkuar të prezantojnë projekte të natyrës së kontratës.
Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se në bazë të paramasës dhe parallogarisë për këtë aktivitetit të prokurimit, rezulton që natyra e aktivitetit të prokurimit ka të bëjë me kontratë "kombinim", ku përfshihen shërbime, punë dhe furnizime. Sipas nenit 15.3 të RrUOPP-së, cilido element i kontratës i cili ka shpenzimet më të larta duhet të klasifikohet nën atë lloj të kontratës. Megjithatë, AK me kërkesën e kualifikimit të aplikuar kundrejt operatorëve dhe të kontestuar nga parashtruesi i ankesës "...projekte të natyrës së kontratës...", në këtë rast mund të kufizohet konkurrenca duke rezultuar me favorizim apo diskriminim të operatorëve ekonomik të caktuar. Prandaj, Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se duhet që t'iu mundësohet operatorëve të ofertojnë me "Projekte (të realizuara) të ngjashme me aktivitetin e prokurimit" me qëllim që të zgjerohet konkurrenca.

Paneli Shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe sqarimeve të ekspertit shqyrtues, vjen në përfundim se AK përmes kërkesës "...projekte të natyrës së kontratës..." mund të ndikoj në zvogëlimin e konkurrencës, ku neni 7 i LPP-së ka përcaktuar se autoritetet kontraktuese nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që

diskriminon në dëm ose në të mirë te një ose më shume operatorëve ekonomik. Andaj, obligohet AK që të ndryshoj kërkesën në fjalë në atë mënyrë që të jenë në përputhje me qëllimin e prokurimit dhe të jetë e orientuar drejt sigurimit të qasjes sa më të mirë për të gjithë operatorët e interesuar ekonomik dhe tenderuesit, gjithashtu te veproj edhe konform nenit 18.9 te RrUOPP-se, si dhe t'i njoftoj OE të interesuar konform dispozitave të nenit 53.7 të LPP-së.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

Goran Milenković

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK Komuna Prizren;

1x1 OE N.P.N. "Renelual Tahiri" – Prizren;

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.